Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Halit Shaljani shpk" të datës 09.11.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sherbimet e përfaqësimit, avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit" me nr. të prokurimit 616-26-7284-2-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **MIRATOHET si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Halit Shaljani shpk" të datës 09.11.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sherbimet e përfaqësimit, avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit" me nr. të prok. 616-26-7284-2-2-1.

II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit.

III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën https://e-prokurimi.rks-gov.net.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Halit Shaljani shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 09.11.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sherbimet e përfaqësimit, avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit" me nr. të prok. 616-26-7284-2-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi 1.

Pragu shtatëvjeçar si kufizim diskriminues i konkurrencës

Pretendimi kryesor i kësaj kërkese është kundërshtimi i kushtit që të paktën një avokat të ketë më shumë se shtatë vjet përvojë pas licencimit. Kërkojmë heqjen e këtij pragu, për aq sa është ruajtur në dosjen në fuqi, sepse përjashton ekipe me avokatë të licencuar dhe të aftë për përfaqësim vetëm për shkak të kohës së kaluar nga licencimi, pa u treguar nevoja konkrete që e bën këtë dallim të domosdoshëm.

Neni 6 paragrafi 1 i Ligjit nr. 04/L-193 për Avokatinë e lidh fitimin e së drejtës për ushtrimin e avokatisë me regjistrimin në regjistrin e Odës. Neni 4 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 përfshin përfaqësimin dhe mbrojtjen para gjykatave dhe organeve të tjera shtetërore. Këto dispozita nuk vendosin një periudhë të përgjithshme pritjeje prej shtatë vjetësh për përfaqësimin gjyqësor.

Pra, avokati që e ka fituar të drejtën për ushtrimin e profesionit mund të marrë përsipër përfaqësim gjyqësor, duke respektuar rregullat procedurale të çështjes konkrete. Përfaqësimi para gjykatës përfshin përgjegjësi të drejtpërdrejtë për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të palës. Në këtë rrethanë, AK duhet të shpjegojë se çfarë detyre të veçantë përmban kjo kontratë që kërkon domosdoshmërisht mbi shtatë vjet licencim, kur e drejta për ushtrimin e të njëjtit profesion dhe përfaqësim është fituar më herët.

Nuk mjafton një pohim i përgjithshëm se avokatët me më shumë vite licencimi janë më të përshtatshëm. AK duhet të identifikojë llojin dhe kompleksitetin e çështjeve, rrezikun konkret dhe lidhjen ndërmjet tyre e pragut të zgjedhur. Në mungesë të këtij arsyetimi, kriteri prodhon trajtim të pabarabartë ndërmjet profesionistëve me të drejtë aktive ushtrimi dhe përbën kufizim të pajustifikuar të konkurrencës, në kuptim të nenit 7 dhe kërkesave të nenit 51 të LPP-së.

Pragu është edhe tepër formal: një avokat me gjashtë vjet praktikë intensive në çështje të krahasueshme mund të përjashtohet nga roli përkatës, ndërsa një avokat me mbi shtatë vjet nga licencimi mund ta plotësojë kushtin pa dëshmuar përvojë të njëjtë relevante. Koha kalendarike nuk zëvendëson vlerësimin e punës së kryer, specializimit dhe aftësisë së ekipit. Po ashtu, formulimi "pas licencimit" nuk merr parasysh përvojën tjetër juridike relevante të fituar më parë.

Licenca nuk e përjashton në vetvete mundësinë ligjore që në prokurim të kërkohet përvojë shtesë; megjithatë kjo përvojë duhet të jetë e nevojshme, e lidhur me kontratën dhe proporcionale. Kundërshtimi ynë është se pragu konkret shtatëvjeçar, pa një lidhje të tillë të provuar, bëhet pengesë diskriminuese. Kërkojmë zëvendësimin e tij me licencë aktive dhe dëshmi objektive të përvojës së krahasueshme, pa kufi automatik shtatëvjeçar.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Pretendimi 2.

Vjetërsia e subjektit dhe format e lejueshme të konkurrimit

Kushti i evidentuar në FDT 9.1 dhe 9.2 që shoqëria e avokatëve të ekzistojë për më shumë se tri vjet e lidh pranueshmërinë me datën e regjistrimit të subjektit. Ky element nuk e dëshmon, në vetvete, aftësinë për kryerjen e shërbimeve. Një subjekt i regjistruar më vonë mund të angazhojë avokatë me përvojë të gjatë, organizim të përshtatshëm dhe burime të mjaftueshme.

Kërkojmë heqjen e këtij kushti, nëse mbetet në fuqi, dhe vlerësimin e kapaciteteve përmes përvojës relevante, licencave, referencave dhe burimeve të disponueshme. Nenet 7 dhe 51.3 të LPP-së kërkojnë trajtim të barabartë dhe kritere proporcionale. Rregullat për kualifikim kërkojnë gjithashtu që operatorët e rinj me aftësi të mjaftueshme të mos përjashtohen vetëm për shkak të kohës së themelimit.

Kërkojmë edhe sqarimin e marrëdhënies ndërmjet kushtit për pjesëmarrje si shoqëri avokatësh dhe FDT 11.1, që lejon grupe operatorësh. Nenet 66 dhe 71 të LPP-së duhet të zbatohen duke respektuar licencimin profesional të atyre që kryejnë shërbimet dhe duke vlerësuar kapacitetet e grupit sipas kërkesave të ligjit. Çdo kufizim i formave të ligjshme të ushtrimit të avokatisë duhet të ketë bazë dhe arsyetim konkret.

Neni 71 paragrafi 1 i LPP-së lejon dorëzimin e tenderit nga një grup operatorësh ekonomikë dhe nuk lejon imponimin e një forme të veçantë juridike për paraqitjen e tenderit. Për këtë arsye, avokatët ose zyrat individuale që plotësojnë kushtet profesionale mund të konkurrojnë së bashku si grup operatorësh ekonomikë; nuk duhet të detyrohen të themelojnë paraprakisht shoqëri avokatësh vetëm për të ofertuar.

Njohja e formave të ushtrimit të profesionit në nenin 2 të Ligjit për Avokatinë dhe lejimi i grupit në FDT 11.1 kërkojnë që dokumentacioni të zbatohet pa përjashtuar zyrat individuale. AK mund të kërkojë marrëveshjen e grupit, përcaktimin e përfaqësuesit, përgjegjësive dhe angazhimeve, si dhe licencën e secilit avokat që kryen shërbimet. Këto dëshmi mundësojnë verifikimin e aftësisë për realizim pa imponuar shoqëri të re në fazën e ofertimit.

Kërkojmë që dosja të përcaktojë shprehimisht pjesëmarrjen individuale ose si grup operatorësh ekonomikë të avokatëve dhe zyrave të tyre të ligjshme. Kapacitetet që ligji lejon të bashkohen duhet të vlerësohen për grupin si tërësi; kushtet që zbatohen veçmas për secilin anëtar dhe licencat profesionale mbeten për t'u verifikuar sipas natyrës së tyre. Formë e veçantë juridike pas dhënies së kontratës mund të kërkohet vetëm në kushtet dhe për nevojën që parashikon neni 71.1, jo si pengesë paraprake për ofertim.

Pretendimi3.

Qartësimi i kërkesave financiare

Në dokumentacionin e mëparshëm, FDT 8.1 dhe 8.2 përmbanin kërkesën për qarkullim prej 200.000 euro, ndërsa FDT 9.1 dhe 9.2 referonin shumën 150.000 euro, krahas shërbimeve të njëjta ose të ngjashme. Formulimet nuk e bënin të qartë nëse bëhej fjalë për dy kushte të ndryshme apo për një kërkesë të ndryshuar që nuk ishte pasqyruar njëtrajtshëm.

Nëse këto formulime janë mbajtur edhe pas korrigjimit të fundit, kërkojmë të përcaktohet: cilat vite financiare përfshihen; nëse pragu 200.000 euro zbatohet për secilin vit, si mesatare apo si total; çfarë përfaqëson shuma 150.000 euro; dhe cilat prova pranohen për secilën kërkesë. Qarkullimi i përgjithshëm, qarkullimi në fushën përkatëse dhe vlera e kontratave të realizuara duhet të dallohen shprehimisht.

Nuk pretendojmë se vetëm krahasimi i këtyre shumave me vlerën e parashikuar provon shkelje të kufirit ligjor. Kundërshtimi lidhet me pasigurinë që krijon kombinimi i tyre dhe me nevojën për arsyetimin e proporcionalitetit. Kërkojmë harmonizim sipas neneve 7, 27, 51 dhe 68 të LPP-së. Nëse ndryshimi i datës 06.11.2026 i ka zgjidhur këto mospërputhje, AK duhet të identifikojë qartë dispozitat përfundimtare dhe kërkesat që janë zëvendësuar.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Pretendimi 4.

Numri i avokatëve dhe kapaciteti i ekipit

Përveç pragut të licencimit, kundërshtojmë minimumin prej pesë avokatësh, nëse ai mbetet në fuqi pa arsyetim të mbështetur në nevojat reale të kontratës.

Për minimumin prej pesë avokatësh kërkojmë të paraqitet lidhja me numrin e çështjeve që pritet të trajtohen njëkohësisht, shpërndarjen e tyre dhe nevojën për specializime. Në mungesë të kësaj lidhjeje, minimumi duhet të ulet në nivelin e domosdoshëm për realizimin e kontratës. Mundësia e angazhimit të avokatëve me marrëveshje, e parashikuar në dokumentacionin e mëparshëm, duhet të zbatohet qartë dhe në mënyrë të barabartë, duke njohur edhe kapacitetet e grupit sipas nenit 71.

Pretendimi 5.

Kushtet e përgjegjësisë kontraktuale

KVK 13.1, sipas versionit të kundërshtuar, përcaktonte dëme të likuiduara prej 0,25% në ditë mbi çmimin final të tërë kontratës dhe kufi maksimal 10% të atij çmimi. Për një kontratë kornizë duhet të bëhet dallimi ndërmjet vlerës së përgjithshme të parashikuar dhe porosisë konkrete që nuk është realizuar në afat.

Nëse formulimi është ruajtur, kërkojmë harmonizimin e tij me rregullat për kontratat kornizë, përfshirë nenin 71A.1(e) të Rregullores së zbatueshme: baza ditore të lidhet me vlerën e shërbimeve të parealizuara dhe kufiri maksimal me vlerën totale të porosisë përkatëse. AK duhet të saktësojë mënyrën e llogaritjes dhe rrethanat në të cilat lind përgjegjësia, në mënyrë që ofertuesit të vlerësojnë saktë detyrimet që marrin përsipër.

Pretendimi 6.

Pasaktësitë e tjera që kërkojnë harmonizim

Kërkojmë kontrollimin e datës së njoftimit në FDT 1.4, përputhjen e titujve të Anekseve 6 dhe 7 me përmbajtjen e tyre, si dhe unifikimin e bazës për sigurimin e ekzekutimit në FDT 14.2 dhe KVK 14.1.

Në njoftimin e fundit vazhdon të figurojë kodi FPP 30241400-4, i përshkruar si softuer i operimit të sistemit, i cili nuk pasqyron objektin e shërbimeve juridike. Kërkojmë korrigjimin e klasifikimit sipas objektit real të kontratës.

Për Aneksin 1 kërkojmë sqarimin e intervaleve të vlerës së kontesteve, peshimit të pozicioneve dhe tarifimit të ndërmjetësimit në raport me çmimoren e plotë. Kjo kërkesë ka për qëllim zbatimin e njëjtë të modelit të çmimeve dhe nuk mbështetet në pretendimin se në skedarin Excel mungon formula.

Pretendimi 7.

Efekti i korrigjimeve dhe afati për përgatitjen e ofertës

Afati aktual për dorëzimin e ofertave është 16.11.2026, ora 14:00. Kërkojmë të verifikohet nëse operatorëve u është siguruar koha ligjore pas vënies në dispozicion të plotë të ndryshimeve të fundit.

Dosja e re figuron e ndryshuar më 06.11.2026, ora 15:40, ndërsa B54 është publikuar më 09.11.2026. Kërkojmë që AK të evidentojë datën dhe mënyrën e komunikimit të plotë të korrigjimeve. Nëse informatat përkatëse janë bërë të disponueshme vetëm më 09.11.2026, duhet të vlerësohet zgjatja e afatit sipas nenit 53.7 të LPP-së, që kërkon së paku dhjetë ditë nga dhënia e informatave përkatëse. Vetëm dallimi ndërmjet datës së dërgimit dhe datës së publikimit nuk mjafton për të përcaktuar komunikimin real.

Për pranueshmërinë kërkojmë vlerësim të veçantë të secilit pretendim sipas nenit 108/A, aktit që kundërshtohet dhe momentit kur përmbajtja e tij është bërë e disponueshme. Shtyrja e ofertimit nuk paraqitet si rihapje automatike e afatit për çdo kusht të pandryshuar. Për çështjet e korrigjuara kërkohet shqyrtim i përmbajtjes së re; për kushtet e ruajtura kërkohet edhe vlerësimi i nevojës për korrigjim nga vetë AK, në përputhje me kompetencat ligjore.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Lidhur me pretendimet me nr. 1 dhe 2 sqarojmë se Komuna e Prishtinës ballafaqohet me lëndë mjaft komplekse dhe mjaft voluminoze. Përfaqësimi dhe mbrojtja e Komunës së Prishtinës në këto raste mund të bëhet vetëm nga OE i cili ka përvojën e mjaftueshme të dëshmuar sipas DT. Përcaktimi i këtyre kërkesave nga njësia kërkuese është bërë duke marrë parasysh llojin, numrin dhe kompleksitetin e rasteve gjyqësore me të cilat ballafaqohet kryeqyteti. Përndryshe, ofertat për pjesëmarrje në këtë aktivitet të prokurimit mund të dorëzohen edhe nga Grupet e OE dhe jo domosdoshmërisht nga OE individualisht. Kjo e drejtë (ofertomi si GOE) është e njohur dhe e garantuar përmes LPP në fuqi. Pretendimet ankimore janë të pabazuara.
Lidhur me pretendimin nr. 3, vlera prej 200,000.00 euro i referohet kërkesës së qarkullimit të OE/GOE në 3 vitet e fundit. Ndërsa vlera prej 150,000.00 euro i referohet kërkesës për kontratat e ngjashme të realizuara në 3 vitet e fundit para publikimit të njoftimit për konratë. Këto dy kërkesa janë të ndryshme, dhe lartësia e tyre mbështetet edhe në UPP (udhëzuesin e prokurimit publik). Pretendimi është i pabazuar.
Lidhur me pretendimin nr. 4, numri i avokatëve është caktuar nga njësia kërkuese mbi bazën e vlerësimit paraprak të ngarkesës me lëndët, llojit dhe kompleksitetit të tyre. Kërkesa është absolutisht e domosdoshme. Përndryshe, ofertat për pjesëmarrje në këtë aktivitet të prokurimit mund të dorëzohen edhe nga Grupet e OE dhe jo domosdoshmërisht nga OE individualisht. Kjo e drejtë (ofertomi si GOE) është e njohur dhe e garantuar përmes LPP në fuqi. Pretendimet ankimore janë të pabazuara.
Lidhur me pretendimin nr. 5 – klauzola për dëmet e likuidura për shkak të OE është klauzolë standarde e kontratës. Pretendimi është i pabazuar.
Lidhur me pretendimin nr. 6 – AK do të rishqyrtojë këtë aspekt të dosjes së tenderit dhe nëse konfirmon mospërputhjet eventuale, të njëjtat do ti korrigjojë. Këto mospërputhje kanë karakter teknik dhe nuk ndikojnë në procedurën apo përmbajtjen e aktivitetit. Pretendimi është pjesërisht i bazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimin e tij nr. 5 por jo edhe pretendimet tjera ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 10.11.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net